



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 56, DATË 05.08.2020

PËR
MOSRINOVIMIN E AUTORIZIMIT TË SHOQËRISË “TELE SPORT” SH.A., PËR
OFRIMIN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE
MBËSHTETUR NË RRJET SATELITOR

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “Tele Sport” sh.a.

Objekt: Mosrinovimi i autorizimit të shoqërisë “Tele Sport” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 dhe neni 68, pikat “a” dhe “b” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullorja “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017,

VËREN

Shoqëria “Tele Sport” sh.p.k., është autorizuar nga AMA me shkresën nr. 529 prot., datë 11.03.2014, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet satelitor. Zona e ofrimit të shërbimit të subjektit është Republika e Shqipërisë. AMA, me vendimin nr. 64, datë 19.03.2018, ka miratuar ndryshime në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Tele Sport” sh.p.k. Afati i vlefshmërisë së autorizimit ka përfunduar në datën 18.01.2019.

Shoqëria “Tele Sport” sh.p.k., në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies

së autorizimeve”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 07.06.2017 të AMA-s, ka shfaqur interes për rinovimin e autorizimit duke depozituar aplikimin me nr. 4710 prot., datë 03.12.2018 dhe nr. 4710/1 prot., datë 05.12.2018.

Në zbatim të urdhrit nr. 315, datë 12.12.2018 të Kryetarit të AMA-s, u mblodh Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) për të shqyrtuar aplikimin e depozituar nga ky subjekt.

KSHD, konstatoi se aplikimi i shoqërisë “Tele Sport” sh.a., për rinovimin e autorizimit për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet satelitor ishte me të meta në dokumentacion pasi nuk përmbushte kërkesat juridike, teknike, programore, organizative dhe të së drejtës së transmetimit.

Konkretisht nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se:

- Nuk është depozituar Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), për të dhënat e shoqërisë “Tele Sport” sh.a., i rifreskuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar, duke qenë se subjekti ka ndryshuar formën e organizimit të tij nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri aksionare), si dhe deklaratat noteriale të ortakëve të shoqërisë zj. Perla Malo; zj. Miranda Malo; zj. Migena Malo; z. Huard Malo dhe z. Enklajd Malo, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Nuk janë depozituar kontratë/marrëveshjet për dhënien dhe lejimin e të drejtave të transmetimit, për vitin 2019 (origjinale, fotokopje të noterizuar).
- Nuk janë depozituar të dhëna për kohën e transmetimit që do të zënë emisionet e prodhuara vetë në raport me gjithë kohën e transmetimit si dhe përmbajtja e programeve kryesore që do të transmetohen.
- Nuk janë depozituar përshkrimi mbi përmbushjen e kushteve teknike të përcaktuara në autorizimin e mëparshëm, gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij autorizimi, projekti teknik i instalimit dhe shfrytëzimit të pajisjeve, i cili të përshkruajë mënyrën e ofrimit të shërbimit, rrjetin satelitor ku do të mbështetet shërbimi i programit audioviziv (është paraqitur vetëm bllokskema) si dhe karakteristikat teknike të pajisjeve që përdoren për ofrimin e shërbimit.
- Nuk është depozituar vërtetimi për pagesat e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e siguruar, (jo më pak se 4 për të gjithë periudhën e mëparshme të vlefshmërisë së autorizimit, vitet 2014-2019).

Në këto kushte, AMA, fillimisht me shkresën nr. 191 prot. datë 11.01.2019, kërkoi nga shoqëria “Telesport” sh.p.k., plotësimin e aplikimit me dokumentacion shtesë. Duke qenë se subjekti nuk ka kthyer përgjigje, AMA me shkresat nr. 216/1 prot., datë 27.02.2019, nr. 216/2 prot., datë 04.11.2019 dhe së fundmi me shkresën nr. 4277 prot., datë 12.12.2019, ka rikërkuar në mënyrë të përsëritur plotësimin e aplikimit përkatës.

Po ashtu, AMA gjatë shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e autorizimit ka kërkuar nga subjekti shlyerjen e detyrimeve financiare, pagesë vjetore për autorizim, pagesë e cila është kundërshtuar nga subjekti, me arsyetimin se duke qenë se nuk ka depozituar dokumentacionin plotësues si dhe nuk ka qenë në transmetim, nuk mund të ngarkohet me këtë detyrim.

Së fundmi, subjekti me shkresën, administruar në AMA me nr. 1647, protokoli, datë 19.06.2020, njofton se nuk ka interes të vijojë ushtrimin e aktivitetit audioviziv si dhe pagesat financiare për vitet 2019 dhe 2020, nuk duhet t'i ngarkohen, pasi nuk ka qenë në transmetim.

Subjekti në shkresën e mësipërme pretendon se:

- Autorizimi i shoqërisë "Telesport" sh.p.k., për transmetim në rrjet satelitor ka përfunduar në datën 18.01.2019 dhe prej kësaj kohe shoqëria nuk disponon autorizim... Shoqëria ka dështuar në përmbushjen e detyrimit të dorëzimit të tërësisë së dokumentacionit për rinovimin e autorizimit. ... Në këto kushte, në mungesë të autorizimit të vlefshëm pa një procedure të rregullt ligjore, të iniciuar për rinovimin e autorizimit, nuk kemi asnjë detyrim kundrejt AMA-s.
- Mungesa e një vendimi nga ana e AMA-s, për mosrinovimin e autorizimit nuk e bën subjektin debitor.
- Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe neni 104 i Kodit të Procedurave Administrative, përcaktojnë se akti administrativ që i ka përfunduar afati, nuk ka më efekt juridik.

Lidhur me pretendimet e mësipërme, AMA vëren se subjekti pavarësisht se është njohur me kërkesat e përsëritura, për plotësimin e dokumentacionit, nuk ka njoftuar mbi mungesën e interesit për vijimin e ushtrimit të aktivitetit audioviziv. Nga ana tjetër, përfaqësues të këtij subjekti kanë shfaqur interes për plotësimin e dokumentacionit pasi herë pas here kanë kërkuar në mjediset e AMA-s, sqarime mbi kërkesat tona për plotësim.

Sa i përket pretendimit mbi konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit, pa u ndërruar nga vendimmarrja e AMA-s, sipas përcaktimeve të nenit 68 të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, licenca/autorizimi bëhet i pavlefshëm kur ka mbaruar afati i saj dhe nuk është rinovuar. Fakti që subjekti ka depozituar aplikim e bën të detyrueshëm vendimmarrjen e AMA-s mbi aplikimin përkatës. Por edhe në të kundërt, nëse subjekti nuk do të paraqiste aplikim për rinovimin e autorizimit, AMA do të shprehej me vendim për konstatimin e mbarimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit.

Subjekti ka detyrime financiare ndaj AMA-s, në masën totale 783,500 lekë, prej të cilave:

- 340,000 lekë, për pagesë vjetore për autorizim për vitin 2019;
- 93,500 lekë kamatëvonesa për vitin 2019;
- 350,000 lekë pagesë vjetore për autorizim për vitin 2020.

Me mosrinovim të autorizimit prej datës 18.01.2019, shuhen detyrimet financiare 93,500 lekë kamatëvonesa për vitin 2019 dhe 350,000 lekë pagesë vjetore për autorizim për vitin 2020. Ndërsa detyrimet financiare për pagesë vjetore për autorizim të vitit 2019 shkojnë në masën 15,836 lekë (340,000 lekë/365 ditë x 17 ditë).

Ndërkohë, nga monitorimet e ushtruara nga AMA, rezulton se gjatë periudhës janar 2019 e në vijim, subjekti e ka ndërprerë aktivitetin audioviziv dhe nuk ka emetuar program audioviziv,

Neni 68 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se: "*Licenca dhe/ose autorizimi bëhet e pavlefshme kur: a) mbaron afati i*

vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar b) i licencuari ose i autorizuari njofton me shkrim AMA-n për mbylljen e aktivitetit”

PËR KËTO ARSYE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19 pika 16 dhe nenit 68, pikat “a” dhe “b” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mosrinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tele Sport” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Tele Sport” sh.a., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet satelitor.
3. Rillogaritjen e detyrimeve financiare për pagesë vjetore për autorizim të vitit 2019, shuarjen e detyrimeve financiare për kamatëvonesa të vitit 2019 dhe pagesë vjetore për autorizim të vitit 2020.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 18.01.2019.

Kryetar:

Gentian SALA

Zëvendëskryetar:

Sami NEZAJ

Anëtarë:

Agron GJEKMARKAJ

Gledis GJIPALI

Suela MUSTA